PETICION

KUNDËR NDËRTIMIT TË JASHTËLIGJSHËM TË OBJEKTIT

Ne, banorët e fshatit Dumnicë e Llugës (Vushtrri) dhe fshatrave simotra të saj(Dumnicë e Epërme,Dumnicë e Poshtme, Zagorë dhe Samadrexhë), nëpërmjet këtij peticioni, me vetëdije, vullnet të plotë dhe vendosmëri, kundërshtojmë ndërtimin e paralajmëruar të një objekti fetar, i cili është konfirmuar përmes njoftimev publike të jetë një Kishë katolike në fshatin tonë.

Duke qenë se absolutisht të gjithë banorët e fshatit dhe banorët jo-rezidentë (të cilët kanë prona aty, por janë zhvendosur me shtëpi) janë myslimanë, por edhe të gjithë banorët e fshatrave rreth Dumnicës së Llugës po ashtu janë myslimanë, ne konsiderojmë se ndërtimi i kësaj Kishe nuk bëhet për qëllime adhurimi, as për nevoja të besimtarëve katolikë, pasi aty nuk ka të tillë, dhe se i tillë nuk i shërben askujt, përveçëse qëllimeve politike e ideologjike

Ne kemi pronat tona aty dhe lidhjet tona me fshatin nuk janë shkëputur, prandaj ndërtimi i kësaj Kishe nuk është në interesin tone, është tendecioz dhe i panevojshëm për ne dhe zonën.

Gjithashtu, kundërshtimi ynë thellohet duke pasur parasysh që iniciativa për ndërtim vjen nga personi ndaj të cilit është ngritur kallëzim penal dhe nga organizata ekstremiste e quajtur “Lëvizja për Rikthim”, e cila haptas shpreh urrejtje, nxitje dhe mosdurim fetar ndaj bashkombasëve shqiptarë të besimit islam.

Andaj, ne nuk shohim asnjë arsye të justifikueshme për ndërtimin e kësaj Kishe, vënies së gurëthemelit me ndonjë makinë punuese, e as vënie simbolikisht të gurëthemelit, prandaj nëpërmjet nënshkrimeve tona përçojmë zërin tonë kundërshtues tek autoritetet, të cilave u bëjmë thirrje të mos lejojnë ndërtimin e saj.

OJQ "Iniciativa për Angazhim Publik"
IAP-V
Vushtrri